



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 686 Akti

Nr. 726 Vendimi
Tiranë, më 15.12.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 15.12.2023, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Belina Zeneli (Kryemadhi)**, ish-prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Belina Zeneli (Kryemadhi) është subjekti rivlerësimi, për shkak të funksionit si në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe bazuar në pikën 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të

gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), në datën 24.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Belina Zeneli do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh komisionere Genta Tafa (Bungo).

3. Komisioni, në datën 12.1.2021, njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit, si dhe për përbërjen e trupit gjykues që do të kryejë procesin e rivlerësimit. Anëtarët e trupit gjykues dhe subjekti i rivlerësimit deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit.

4. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

5. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit:

- a. plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë AKSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c. plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

6. Komisioni është vënë në dijeni të faktit publik se KLP-ja, me vendimin nr. ***, datë 31.1.2022, me shumicë votash ka vendosur: “Pranimin e kërkesës të paraqitur nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor ndaj prokurores Belina Zeneli (Kryemadhi) për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, parashikuar nga neni 148/d, pika 2, germa “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, gjerat “ç” dhe “d”, neni 105, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 111, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për magjistraten Belina Zeneli (Kryemadhi), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër”.

7. Ky vendim i KLP-së është ankimuar nga subjekti pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit më 20.6.2022. Subjekti në këtë ankim ka kërkuar: “Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 31.1.2022, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

8. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me vendimin nr. ***, datë 24.10.2023, ka vendosur: “Mospranimin e ankimit të magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi) kundër vendimit nr. ***, datë 31.1.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi), prokurore në Prokurorinë e Shkallës së Parë Dibër”.

9. Ky vendim ka hyrë në fuqi menjëherë, pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 175, datë 6.12.2023, faqja 21460.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

10. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

11. Trupi gjykues konstaton se znj. Belina Zeneli (Kryemadhi) ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.

12. Në referim të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera, përcaktohet se: “*Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur shkarkohet nga funksioni*”.

13. Trupi gjykues u njoh me vendimin nr. ***, datë 24.10.2023, të Kolegjit, që ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 31.1.2022, të KLP-së, i cili ka vendosur: “Pranimin e kërkesës datë 29.1.2021, të paraqitur nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedim disiplinor ndaj prokurores Belina Zeneli (Kryemadhi), për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, parashikuar nga neni 148/d, pika 2, germa “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, germat “ç” dhe “d”, neni 105, pika 1, faqja 3 nga 19, germa “dh” dhe neni 111, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për magjistraten Belina Zeneli (Kryemadhi), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër”.

14. Ky vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 175, datë 6.12.2023.

15. Trupi gjykues, pasi diskutoi çështjen në tërësi, gjykon se mbarimi i statusit të magjistratit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen.

16. Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative ka parashikuar *pamundësinë në objekt apo qëllim*, ku sipas kësaj dispozite organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

17. Në zbatim të kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit nuk e gëzon më statusin e magjistratit dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson të përfundojë procesin e rivlerësimit kalimtar për znj. Belina Zeneli (Kryemadhi), pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikën 6 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2/b të nenit 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Belina Zeneli (Kryemadhi) pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit.
2. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 15.12.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Genta TAFA (BUNGO)
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Gledis Hajdini